

VENDIM
Nr. 19/2024

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR SHËRBBIMET PUBLIKE
TË STERILIZIMIT DHE TË CHECK-UP NË SHËNDETËSI**

(Ndryshuar me Vendimin nr. 73/2024, datë 25.7.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 25 të rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Shërbimin Publik të Sterilizimit dhe Shërbimin Publik të *Check-up* në Shëndetësi.

II. Komisioni Hetimor ka për objekt të veprimtarisë së tij:

i) shqyrtimin e çështjeve të lidhura me kontratat publike për shërbimin publik të sterilizimit dhe atë të *check-up*-it në shëndetësi, si dhe zbatimin e tyre;

ii) vlerësimin e nevojës për marrjen e masave administrative apo ndërhyrjet ligjore në legjislacionin përkatës.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe respektimit të jetës private të individit.

IV. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime për marrjen e masave me karakter administrativ dhe/ose ndryshime të nevojshme ligjore.

V. Komisioni Hetimor do të përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët kryetari dhe 6 (gjashtë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe 8 (tetë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste si më poshtë:

1. Albana Vokshi	kryetar	PD
2. Plarent Ndreca	nënkryetar	PS
3. Klodiana Spahiu	anëtare	PS
4. Milva Ekonomi	anëtare	PS
5. Ilirjan Pendavinji	anëtar	PS
6. Ilir Metaj	anëtar	PS
7. Edona Bilali	anëtare	PS
8. Petro Koçi	anëtar	PS
9. Klevis Xhoxhi	anëtar	PS
10. Zheni Gjergji	anëtare	PD
11. Ina Zhupa	anëtare	PD
12. Edmond Spaho	anëtar	PD
13. Saimir Korreshi	anëtar	PD
14. Xhelal Mziu	anëtar	PD
15. Petrit Vasili	anëtar	PD

Anëtarët zëvendësues

1. Lindita Buxheli *anëtar zëvendësues* PS¹

¹ Vendimi nr. 73/2024, datë 25.7.2024, botuar në F.Z. nr. 136, datë 5.8.2024 në pikën I të tij shprehet: “*Lindita Buxheli*”

2. Mirela Pitushi	anëtare zëvendësuese	PS
3. Emilia Koliqi	anëtare zëvendësuese	PD
4. Ilda Dhor	Anëtare zëvendësuese	PD
5. <i>Alban Xhelili</i>	anëtar zëvendësues	PS
6. <i>Elda Hoti</i>	anëtare zëvendësuese	PD.

VI. Komisioni Hetimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 4-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevoje, me kërkesë të arsyetuar të Komisionit, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.

VII. Ngarkohen kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni Hetimor.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 21.3.2024.

zëvendëson anëtarin zëvendësues Lavdrim Krashi, si dhe caktohen anëtarë zëvendësues:

- *Alban Xhelili* PS;
- *Elda Hoti* PD.”